



Prishtinë, 10.07.2025
Kodi i ZRRE-së: V_2790_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRrE/DMK_V_2702_05_25** i datës 19.05.2025;
- Ankesa e konsumatorit e datës 13.06.2025.

në seancën e mbajtur më datë 10.07.2025 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit N. M., (ankesa e parashtruar nga A. M.,) nga Komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
- II. **MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2702_05_25 i datës 19.05.2025.
- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 19.05.2025 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2702_05_25 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e konsumatorit N. M., lidhur me kontestimin e faturës me nr. 12240DPR – 120502, në vlerë prej 277.08 EUR.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori N. M., (ankesa e parashtruar nga A. M.,) brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- DMK nuk i ka shqyrtuar në tërësi faturat e kontestuara dhe për të cilat kam parashtruar ankesë;
- Faturat janë të fryra dhe se nuk është i saktë evidentimi i shpenzimeve;
- Unë jetoj vetë, në shtëpi dhe shpenzimet janë minimale;
- Kërkon ndërrimin e njehsorit, dhe i kërkon Bordit që ankesa të pranohet si e bazuar dhe vendimi i DMK-së dhe KESCO të refuzohet.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 10.07.2025 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 13.06.2025; Vendimin e DMK të datës 19.05.2025; Ankesën e konsumatorit në KESCO të datës 14.01.2025; Përgjigjën e KESCO-s të datës 05.02.2025, Ankesën e konsumatorit në DMK të ZRrE-së të datës 21.02.2025; Procesverbalin me nr. 0018451 të dt. 25.04.2025; Fotografitë e njehsorit; Njoftimin nga KESCO-ja të dt. 25.04.2025; Transaksionet e konsumatorit, Rrjedhën e Energjisë Elektrike dhe Listat e Leximit.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit/konsumatorit **është e pabazuar**, sepse:

Me datë 30.12.2024, Departamenti i Faturimit në KESCO i ka dërguar konsumatorit faturën me nr. 12240DPR-120502, në vlerë prej 277.08 €. Me datë 14.01.2025, konsumatori ka parashtruar ankesë në KESCO duke e kundërshtuar këtë faturë, nën dyshimet për matje jo të saktë të energjisë elektrike me njehsorin me nr. 32600412. Pas shqyrtimit dhe analizimit të ankesës së konsumatorit, Departamenti për Kujdes ndaj Konsumatorëve në KESCO, lëshon një Vendim, me të cilin refuzohet ankesa e konsumatorit, dhe atë duke u bazuar në leximet e bëra përmes AMR-lexime nga distanca, rrjedhës së energjisë elektrike dhe transaksioneve.

Me datë 21.02.2025, i pakënaqur me këtë Përgjigje, konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, duke e kontestuar faturën 12/2024 si dhe faturimin nën dyshimet për matje jo të saktë të energjisë elektrike me njehsorin me nr. 32600412. Konsumatori i propozon DMK-së që ankesa të aprovohet, ashtu që fatura e kontestuar të rishqyrtohet në tërësi.

Bordi e ka analizuar rrjedhën e energjisë elektrike si dhe listat e leximit konstaton se konsumatori ka lexime të rregullta mujore, vetëm në disa periudha lexuesit e KEDS-it kanë evidentuar “Mungon blloba si dhe nuk ka qasje në lexim”, por që kjo nuk ka ndikim në faturimet kontestuese të konsumatorit, kurse nga periudha 06/2018 kur edhe është vendosur për matje njehsori elektrik nr. 32600412 leximet dhe faturimet e konsumatorit janë bërë nga distanca përmes AMR.

Duke pasur parasysh pretendimet e konsumatorit se shpenzimet e periudhës 12/2024 krahasuar me periudhat e me hershme dallojnë shume, është bërë krahasimi i shpenzimeve të konsumatorit për periudhat të njëjta të me hershme me njehsorin elektrik nr. 32600412. Bazuar në analizën e rrjedhës së energjisë elektrike konstatohet se konsumatori ka rritje të shpenzimit kryesisht gjatë periudhës dimërore përkatësisht periudhës tetor-mars. Sipas rrjedhës e energjisë elektrike konstatohet se mesatarja e shpenzimeve të konsumatorit për periudha të njëjta kohore janë: periudha 10/2019-03/2020 është **3,582 kWh**, periudha 10/2020-03/2021 është **4,096 kWh**, periudha 10/2021-03/2022 është **4,070 kWh**, periudha 10/2022-03/2023 është 1,733 kWh, periudha 10/2023-03/2024 është 1,241 kWh si dhe periudha kontestuese 10/2024-03/2025 është 3,698 kWh. Andaj bazuar në analizën e këtyre shpenzimeve vërtetohet se konsumatori ka luhatje të ulëta në periudha të ndryshme por që nuk ka dallime në shpenzim të energjisë elektrike.

Konsumatori në ankesën e tij thekson se nga ndërrimi i njehsorit elektrik, pra periudha 06/2018 ka rritje të faturimit, por që bazuar në analizën e shpenzimeve të energjisë elektrike edhe me njehsorin e vjetër nr. 32779537 vihet re se kjo nuk qëndron për shkak se për periudha të njëjta kohore konsumatori



ka shpenzime me te larta me njehsorin e vjetër elektrik nr. 32779537. Sipas rrjedhës e energjisë elektrike konstatohet se mesatarja e shpenzimeve te konsumatorit me njehsorin e vjetër elektrik nr. 32779537 per periudha te njëjta kohore janë: periudha 10/2017-03/2018 është 5,068 kWh, periudha 10/2016-03/2017 është 6,019 kWh, si dhe periudha 10/2015-03/2016 është 4,440 kWh.

KEDS ka ofruar procesverbalin e ndërrimit te njehsorit elektrik nr. 0018451 te datës 25.04.2025 me te cilin vërtetohet se është larguar nga matja njehsori elektrik nr. 32600412 me gjendje TL=112888 kWh dhe TU=064787 kWh. Ekipet e KEDS-it po ashtu kane evidentuar ne procesverbal se: *“Me kërkesë te menaxhmentit bëjmë ndërrimin e njehsorit SMART. Njehsori paraparak merret futet ne qese pllombohet dhe dërgohet ne Q.K”*. Bordi e ka shqyrtuar procesverbalin e ndërrimit te njehsorit elektrik dhe konstaton se ekipet e KEDS-it nuk kane evidentuar çfarëdo dëmtimi apo edhe dyshimi ne matje, si dhe kWh e regjistruar në procesverbal përputhën plotësisht me faturimin e konsumatorit në CCP për periudhën 03/2025.

Bazuar në shqyrtimin e faturës kontestuese, rrjedhës se energjisë elektrike, listave të leximit konstaton se KESCO me rastin e faturimit të konsumatorit përfshirë edhe periudhat kontestuese ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji e ku thuhet se: 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar edhe për tarifat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.*

Tutje, duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me Energji elektrike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, *“të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”*, andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë elektrike të cilën e ka shpenzuar.

Bordi i ZRRE pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Rregullën për Shkycjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë, transaksionet e konsumatorit, Listat e leximit, Rrjedhën e energjisë elektrike, si dhe dokumentet e tjera si në shkresat e lëndës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.



Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit **N. M., (A. M.,)** dhe
- Arkivit të ZRRE-së.